



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK  
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

Nr. 3783/12 Prot.

Tiranë, më 08.07.2024

**Të dhëna mbi Vendimin  
Nr. 48, datë 20.05.2024**

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP"), në mbështetje të nenit 78/1/a të Ligjit 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar (në vijim "LPP"), në ushtrim të kompetencave, me Vendimin Nr. 48, datë 20.05.2024 ka vendosur të përjashtojë për 6 (gjashtë) muaj operatorin ekonomik "LLAZO" Shpk me NIPT K24218401K nga e drejta për të fituar kontrata publike, për keqinformim për qëllime kualifikimi, në procedurat e prokurimit.

**1. Arsyet e heqjes së emrit të operatorit ekonomik nga lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike**

Kundër këtij vendimi, shoqëria "LLAZO" shpk, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Lushnjë, ku ndër të tjera, ka kërkuar sigurimin e padisë, si dhe pezullimin e zbatimit të aktit administrativ Vendimit Nr. 48, datë 20.05.2024 të APP.

APP është njohur me dispozitivin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë Nr. 89-2024-1433, datë 03.07.2024, nëpërmjet vërtetimit të lëshuar nga kjo e fundit me Nr. Extra Prot., datë 04.07.2024, i cili është administruar dhe protokolluar në institucion me Nr. 3783/10 Prot., datë 05.07.2024. Në këtë dispozitiv, Gjykata ndër të tjera, ka vendosur pranimin e kërkesës së shoqërisë "LLAZO" shpk për marrjen e masës së sigurimit të padisë, si dhe pezullimin e zbatimit të Vendimit Nr. 48, datë 20.05.2024 të APP, deri në përfundim të çështjes në themel të saj.

Në nenin 510/a të Kodit të Procedurës Civile, parashikohet se: "*Janë tituj ekzekutivë: a) vendimet civile të formës së prerë të gjykatës, që përmban një detyrim, vendimet e dhëna prej saj për sigurimin e padisë, si dhe për ekzekutimin e përkohshëm*".

Në këto kushte, në mbështetje nenit 510/a të Kodit të Procedurës Civile, si dhe të nenit 180, pika 1, gërma "b" të Ligjit Nr. 44/2015 "Kodi i procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë", APP ka vijuar duke proceduar me heqjen e emrit të këtij operatori ekonomik nga lista e operatorëve ekonomikë të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në faqen zyrtare të APP. Ky vendim qëndron në fuqi deri në marrjen e një vendimi përfundimtar.